

VENDIM
Nr.147, datë 18.3.2005

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË TË PËRDORË PROCEDURËN
“PROKURIM I DREJTPËRDREJTË” PËR REALIZIMIN E SHËRBIMIT TË KOLAUDIMIT
DHE TË SHPËRNDARJES SË MEDIKAMENTEVE E TË MATERIALEVE TË MJEKIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë që për fondin e vet limit prej 59 087 000 (pësedhjetë e nëntë milionë e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekësh, të miratuar në buxhetin e vitit 2005, zëri “Shpenzime korrente”, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me “Fu-Farma” sh.a., për realizimin e shërbimit të kolaudimit dhe të shpërndarjes së medikamenteve e të materialeve të mjekimit, për institucionet e kujdesit shëndetësor që ka në varësi.

2. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano